



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:067300
Datë: 16.07.2021
Numri i dokumentit: 02005434

A.nr.1024/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditësit [“L...” sh.p.k] me seli në Gjakovë kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim doganor, në seancën publike të mbajtur me datë 06.07.2021, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET Kërkesëpadia e paditësit [“L...” sh.p.k] me seli në Gjakovë.

ANULOHET Aktvendimi nr.01.3.2.2/5083 i datës 08.05.2020 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

A R S Y E T I M

Me aktvendimin kontestues e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit R-7516 të datës 11.03.2020 të Zyrës së Brendshme Doganore Prizren, si e pabazuar.

Paditësi [“L...” sh.p.k] me seli në Gjakovë, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 12.06.2020, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, të ndryshohet aktvendimi nr. 01.3.2.2/5083 i datës 08.05.2020, ashtu që vlerësimi i mallit të deklaruar për import të bëhet sipas faturave të paraqitura ose aktvendimi të prishet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Paditësi në padinë e tij dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: në arsyetimin e aktvendimit të goditur Dogana e Kosovës konsideron se kinse “vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlere reale e paguar për mallin me qëllim importi në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlere më e vogël se sa vlere reale e paguar...” dhe për këtë arsye ka konstatuar se malli nuk mund të vlerësohet sipas nenit 33 dhe 34 të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës dhe se Dogana e Kosovës me të drejtë ka vepruar duke bërë vlerësimin e mallit në pajtim me nenin 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Në aktvendim është dashur të konstatohet drejtë se cilat janë ato fakte vendimtare në bazë të cilave Dogana e Kosovës e ka arsyetuar vendimin e saj. Në rastin konkret fakt vendimtar do të duhej të ishte se si është përcaktuar vlere e mallit të deklaruar. Dogana e Kosovës pa asnjë arsyetim të bindshëm nuk i ka marr për bazë faturat e importuesit për të vlerësuar mallin e importuar e

që ka rezultuar me vlerësimin më të lartë të mallit, të njëjtin mall të importuar me çmime të njëjta në vitin 2019 e ka vlerësuar në bazë të faturave. Ky ndryshim i vlerësimin të mallit ka rezultuar me kosto më të lartë të mallit, kosto të cilën subjekti ankimes nuk mund ta bartë në çmimin me pakicë të mallit pasi që nuk do të ishte konkurrent në treg dhe me këtë rast të njëjtit i është shkaktuar dëm i konsiderueshëm. Andaj paditësi konsideron se aktvendimi i goditur është marr duke u vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 182 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili zbatohet përshtatshëmish në procedurën administrative. Përfaqësuesi i autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: mbetem në tërësi pranë ankesës respektivisht kërkesëpadisë së datës 12.06.2020 sipas të cilës subjekti ankimor ["L..." sh.p.k] pretendon se malli i importuar është zhdoganuar jo drejtë në kuptim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, me kuotën MV-6, ndërkaq ky mall është dashur të zhdoganohet sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, pasi që vlera doganore e mallit të importuar ka mundur të përcaktohet saktë në bazë të kontratës së shitblerjes dhe deklaratave eksportuese të cilat Dogana i ka pasur si prova. Njëkohësisht paditësi këtë mall e ka importuar rregullisht edhe në të kaluarën dhe i njëjti gjithmonë është vlerësuar me kuotën MV-1. Dallimi në vlerësimin e mallit të njëjtë doganor për paditësin ka rezultuar në rritjen e koston së përgjithshme të mallit për 4,866.24€ e që në shitje me pakicë është detyruar këtë mall ta shes me humbje. Andaj i propozojmë gjykatës që pas shqyrtimit të provave të aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën-padinë e paditësit dhe ta detyroj Doganën e Kosovës që të rivlerësoj mallin me kuotën MV-1 sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe shumë e lartcekur t'i kthej paditësit. Lidhur me pretendimin e Doganës se paditësi nuk e ka pasur deklaratën eksportuese duhet t sqarojmë se deklarata eksportuese vjen me 4 muaj vonesë nga Kina pasi që pagesa bëhet pas pranimit mallit kompanisë amerikane dhe tani në padi deklaratën eksportuese ia kam bashkangjitur si provë gjykatës. Përmes parashtresës i autorizuari i ka dorëzuar gjykatës deklaratën eksportuese të shtetit eksportues Kinë dhe e përkthyer në gjuhën shqipe, kontratën e distribuimit, swift transferi i pagesës bankare. Duke shtuar se mos përputhja e vlerës së faturës me transaksionin bankar është si rrjedhojë e kredit notës-zbritjes në shumë prej 800.00USD të cilën shumë distributori e ka zbritur nga pagesa për mallrat të cilat paditësi i ka paguar paraprakisht dhe nuk kanë qenë me kualitet konform.

E paditura në përgjigje në padi datës 02.04.2021 dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: e kundërshtojmë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjisllacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi: e kundërshtoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, si të pa bazuar dhe i propozojmë gjykatës që të njëjtën ta refuzoj si të pa bazë duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar si të ligjshëm dhe të drejtë, për arsye se ky vendim është marr konform dispozitave ligjore në fuqi dhe si i tillë konsiderohet i ligjshëm dhe i drejtë. Po ashtu Dogana e Kosovës edhe njëherë thekson se në fazën e zhdoganimit të mallit e po ashtu edhe në fazën e rishqyrtimit të vendimit paditësi nuk e ka prezantuar deklaratën eksportuese të mallit e as kontratën mbi shitblerjen e mallit duke potencuar faktin se deklarata eksportuese e mallit lëshohet për secilin mall që lëshon mallin eksportues e po ashtu në këtë rast mungon edhe transferi bankar lidhur me pagesën e mallit ku në fazën e rishqyrtimit të vendimeve është paraqitur një transfer bankar i cili mban shumë 30,532.87 USD e që nuk është në përputhje me faturën, i cili transfer po ashtu është në statusin përgatitur e jo ekzekutuar, gjithmonë duke iu referuar faturës së mallit ku payments terms apo kushtet e pagesës ka të shkruar që pagesa bëhet në kesh. Gjithashtu e kontestoj vlerën e kontestit lidhur me këtë lëndë pasi që sipas të dhënave të cilat nxirren nga ASYCUDA dallimi në mes të vlerës së deklaruar dhe asaj të rivlerësuar është 1,450.11€ dhe si të tillë e kundërshtoj pretendimin e paditësit lidhur me diferencën e pagesës së mallit.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 06.07.2021 administroi këto prova: përgjigja në padi e datës 02.04.2021

e Doganës së Kosovës, aktvendimi nr. 01.3.2.2/5083 i datës 08.05.2020 i Doganës së Kosovës, kontrata e shitblerjes e lidhur në mes të importuesit dhe eksportuesit, fatura e mallit, deklarata doganore, marrëveshja e shpërndarjes nr. 00257/20 e datës 06.06.2020, deklarata doganore për mallrat e eksportuara të Republikës Popullore të Kinës, packing list, procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave i datës 11.03.2020, dosja e vlerës, pagesa bankare e datës 28.02.2020.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, në seancën e mbajtur me datë 06.07.2021, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thëniet në ankes-padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, dhe konstatoi se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar andaj vendosi që lëndën ta kthej në rishqyrtim për këto arsye:

Pala paditëse me kërkesën për rishqyrtim datës 09.04.2020 ka kërkuar nga e paditura të anuloj rivlerësimin nga zyra e pranimit qëndror me arsyetimin se ky rivlerësim është i padrejtë, jo ligjor. Ka paraqit dokumentacionin e kompletuar ku është paraqit vlera e cila realisht është e paguar dhe zyra doganore është dashur të veproj konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave bazuar në dokumentacionin e prezantuar dhe posedojmë swiftin e bankës që dëshmon transaksionin e pagesës.

E paditura ne procedurën administrative të ankesave, nxjerr vendimin kontestues me të cilin refuzon kërkesën e paditësit. Këtë vendim e paditura e ka mbështetur në bazë të dhënave të disponueshme respektivisht zhdoganimeve të mëhershme dhe dosjes së vlerës, dhe të dhënave nga Sektori i Vlerës, duke përcaktuar vlerën reale të mallit lëndor kontestues. E paditura e konsideron si provë të pamjaftueshme dokumentacionin përcjellëse të mallit lëndor, sepse paditësi nuk ka prezantuar kontratën e shitblerjes, mungon deklarata eksportuese.

Edhe pse e paditura ka nxjerr vendimin kontestues në bazë të kërkesës së paditësit të ushtruar ndaj vendimit nr.R-7516/11.03.2020 të lëshuar nga Zyra e Brendshme Doganore Prizren, gjykata konsideron se nuk është i mjaftueshëm vetëm konstatimi se Sektori i pranimit qëndror, ka aplikuar drejt metodën e vlerësimit kur ka kontestuar vlerën e mallit sipas të dhënave të disponueshme, pa u administruar pretendimet e paditësit i cili kërkon që të shqyrtohet çmimi i mallit lëndor të deklaruar sipas faturës MI078441. Asnjë dispozitë ligjore nuk e parashihet se malli lëndor duhet të vlerësohet sipas metodës së 6 të vlerësimit nga dosja e vlerës të dhëna të marra nga Sektori i Vlerës, në rast se vlera e dokumentacionit përcjellës të mallit nuk përputhet me të dhënat e disponueshme, pa u bërë verifikimi i vlerës së deklaruar të mallit lëndor gjegjësisht pa u shqyrtuar metodat paraprake të vlerësimit nga neni 33-34 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Paditësi i ka paraqit gjykatës provat materiale si: faturën e mallit doganor nr.MIO78441-01 të datës 23.01.2020, pagesën bankare të datës 28.02.2020, kredit notën-zbritjen në shumë prej 800.00USD, deklaratën eksportuese, kontratën e distribuimit nga Abro Industries INC-Shetet e Bashkuara të Amerikës, Letërkonfirmimin e datës 12 Mars 2020 se paditësi ka të drejtën ekskluzive në tregun e Republikës së Kosovës, fakte këto të cilat e paditura fare nuk i ka shqyrtuar apo kontestuar në procedurën administrative të ankesave.

Gjykata konstaton se e paditura nuk i ka bazuar konstatimet e veta në asnjë dispozitë ligjore, nuk ka prezantuar asnjë provë materiale që do të dëshmonte faktin se paditësi nuk ka deklaruar vlerën reale të mallit, apo i ka paguar eksportuesit vlerë më të vogël se vlera e pagesës bankare dhe vlerës se faturës së mallit doganor. E paditura nuk ka provuar ti shqyrtoj të gjitha dokumentet përcjellëse të mallit lëndor, por duke iu shmangur pretendimeve ankimore të paditësit, nuk vërteton gjendjen faktike nga dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor,.

Me qëllim të konstatimit të drejt të çështjes, me prova materiale shtesë, lidhur me kontestin e vërtetësisë së dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor, gjykatës i duhet sqarim plotësues, verifikim dhe sigurim i provave shtesë, në mënyrë që konstatimi i dhënë në arsyetim të aktvendimit të kontestuar të mbështetet në prova materiale.

Gjykata kërkon nga e paditura Dogana e Kosovës që në ri procedurë para se të shqyrtoj të dhënat e disponueshme nga dosja e vlerës, dhe zhdoganimet e mëhershme nga Sektori i Vlerës, të vlerësoj metodat paraprake të vlerësimit, të verifikoj vërtetësinë e dokumentacionit përcjellës të mallit në aspektin e harmonizimit të vlerës së mallit të deklaruar, ashtu që të shqyrtoj pretendimet e paditësit se ka prezantuar dokumentet e nevojshme që kërkohen me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 mbi implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, të kërkohet nga pala paditëse, deklarata eksportuese, kontrata e distribuimit, dhe të verifikohet se vlera e paguar e faturës të mallit lëndor sipas transferit bankar, kredit notës-zbritjen, harmonizohet me vlerën e deklaruar të mallit kontestues. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit dhe të aplikoj drejt dispozitën ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallit.

Duke pasur parasysh konstatimet e sipërcekura, gjykata konkludon se në këtë konflikt administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshëm të vendimit të kontestuar, ku ka rezultuar të mos dihen arsyet e mos kontestimit të vërtetësisë së dokumentacionit të mallit të prezantuar në procedurën administrative të ankesave. Andaj në këtë drejtim gjykata bazuar në autorizimet nga nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102, neni 43 par.2 të LKA-së e detyron organin e paditur Dogana e Kosovës në Prishtinë, që në riprocedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejt të gjitha faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejtë të çështjes.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje administrative/Divizioni Fiskal
A.nr.1024/20 datë 06.07.2021

Gjyqtari,
Krenar Berisha

KESHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.